

Emri dhe mbiemri \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_

**Pjesa B: Pyetje: E saktë / E pasaktë – 2 pikë secila (gjithsej 10 pikë)**

1. Asetet jo-qarkulluese janë para ose burime tjera të cilat pritet të konvertohen në para ose konsumohen gjatë vitit të ardhshëm fiskal
  - E saktë**
  - E pasaktë
2. Në kontabilitet, termi “njohje” do të thotë “të regjistruara në sistemin e kontabilitetit”
  - E saktë**
  - E pasaktë
3. Të hyrat dhe shpenzimet quhen llogari të përhershme.
  - E saktë
  - E pasaktë**
4. Teprica në mes të çmimit blerës të kompanisë me vlerën e tregut të aseteve neto të asaj pasurie është e njohur si goodwill (emri i mirë).
  - E saktë**
  - E pasaktë
5. Asetet jo-qarkulluese raportohen në bilancin e gjendjes sipas vlerës së tyre të tregut.
  - E saktë
  - E pasaktë**
6. Firmat duhet të njohin shpenzimet që kanë të bëjnë me llogaritë e tyre të pambledhshme në momentin kur ato llogari shlyhen në tërësi.
  - E saktë
  - E pasaktë**
7. Në periudhat kur kemi rritje të çmimeve të stoqeve, sipas metodës LIFO, stoqet në fund në bilanc të gjendjes kanë vlerë më të lartë se sa nëse përdoret FIFO.
  - E saktë
  - E pasaktë**
8. Sipas sistemit të vazhdueshëm të stoqeve, kosto e mallit të shitur përcaktohet në fund të periudhës fiskale.
  - E saktë
  - E pasaktë**

9. Të hyrat në pasqyrën e të ardhurave raportohen si të hyra neto pas zbritjes së zbritjeve dhe kthimeve nga shitja.

- E saktë**
- E pasaktë

10. Financimi me ekuitet është rezultat i përfitimit të burimeve financiare nga pronarët.

- E saktë**
- E pasaktë

**Pjesa B: Pyetje me zgjidhje shumëfishe, vetëm njëra nga përgjigjet është e saktë. Secila përgjigje e saktë 2 pikë (gjithsej 10 pikë)**

1. Cila nga elementet e mëposhtme NUK do të përfshihej në pronë, makineri dhe pajisje?

- a. pajisjet
- b. ndërtesat
- c. goodwill**
- d. toka

2. Cila nga metodat e zhvlerësimit shpërndan pjesë më të madhe të kostos së aseteve jo-qarkulluese si shpenzim në pjesën e hershme të jetës së atij aseti?

- a. drejtëvizore
- b. zhvlerësimi i përshpejtuar**
- c. njësisive të prodhimit
- d. zëvendësimit

3. Kur shitet një pasuri jo-qarkulluese, fitimi ose humbja nga kjo shitje llogaritet si diferencë në mes të

- a. vlerës së tregut dhe zhvlerësimit të akumuluar
- b. çmimit shitës dhe zhvlerësimit të akumuluar
- c. vlerës së tregut dhe çmimit shitës
- d. çmimit shitës dhe vlerës në libra**

4. Kompania ndërtimore Arti është e specializuar në projekte ndërtimore afatgjata. Varësisht nga rrethanat, Arti duhet të njeh të hyrat

<u>Nga pak çdo vit</u>	<u>Në momentin e</u>
<u>Ashtu siç është progresi i punës</u>	<u>nënshkrimit të kontratës</u>
<b>a. Po</b>	<b>Jo</b>
b. Jo	Jo
c. Po	Po
d. Jo	Po

5. Sipas kontabilitetit akrual, shitjet që bëhen me kredi (afat pagese) zakonisht raportohen si
- detyrime
  - të hyra**
  - para nga aktivitetet operative
  - kundër-llogari e shitjeve

**Pjesa C: Pyetje me zgjidhje shumëfishe – me llogaritje, 5 pikë secila (gjithsej 15 pikë)**

1. Në fillim të marsit, ndërmarrja për botimin e revistave Artea kishte në llogarinë e të hyrave të pafituara (të hyra të shtyra) 15,000 abonime vjetore për revistë nga €18 secila. Gjatë marsit, kompania mori edhe 4,000 abonime vjetore të reja nga €18 secila. Botimi i muajit mars të kësaj reviste ishte dërguar te abonuesit me 20 mars. Shuma e të hyrave që duhet të njihet në mars do të jetë
- €15,000
  - €28,500**
  - €72,000
  - €270,000
  - €342,000

2. Kompania Buki shet vazo. Informatat mbi aktivitetin e stokeve gjatë kësaj jave janë paraqitur më poshtë:

	<u>Njësi</u>	<u>Kosto për njësi</u>	<u>Gjithsej kosto</u>
Stoqe në fillim	2	€ 6	€12
Blerje	4	8	32
Blerje	6	10	60

Nëse gjatë javës janë shitur 5 njësi, sa është KOSTO E MALLIT TË SHITUR nëse përdoret metoda LIFO?

- €68
  - €54
  - €50**
  - €36
3. Me 1 janar 2010, laborator Medica ka blerë një pajisje të re në vlerë prej €400,000. Pajisja ka një jetë të përdorimit prej 10 vjet dhe vlera e mbetur është €50,000. Pas të gjitha llogaritjeve me 31 dhjetor 2010, sa do të jetë zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera në libra e kësaj pajisjeje? (supozoni se përdoret metoda drejtvizore e zhvlerësimit.)

Zhvlerësimi i akumuluar	Vler në libra
<u>Me 31 dhjetor 2011</u>	<u>Me 31 dhjetor 2011</u>
<b>a. €70,000</b>	<b>€330,000</b>
b. €70,000	€280,000
c. €35,000	€330,000
d. €80,000	€320,000

## Pjesa D: Probleme (gjithsej 55 pikë)

### 1. (15 pikë)

Me 20 maj, kompania HD ka blerë 2,000 karrige me një çmim fature prej €150 për secilën karrigë. Kompania pagoi këto karrige me 30 maj, duke fituar një zbritje prej 2% për pagesë me kohë. HD i shiti të gjitha këto karrige me çmim prej €200 secilën. Konsumatorët e HD poashtu fituan një zbritje prej 2% nga shitja.

- a. Cilën shumë duhet ta raportoj HD si shitje neto? **392,000**
- b. Cilën shumë duhet ta raportoj HD si kosto të mallit të shitur? **294,000**

2. Kompania ODF regjistron shitje totale prej €3,600,000 gjatë vitit 2010. Edhe pse kompania i përzgjedhë me kujdes blerësit (konsumatorët), gjithmonë ekzistojnë disa konsumatorë të cilët nuk do të paguajnë ose nuk mund të paguajnë.

#### Kërkohe:

Tregoni si do të regjistrohen ngjarjet e mëposhtme në sistemin e kontabilitetit.

- a. Në fund të vitit, vlerësohet se 4% e shitjeve nuk do të mbledhen (arkëtohen).
- b. Kompania kuptoi se konsumatori i saj Agness Oli ka ikur në një shtet tjetër dhe nuk ka paguar borxhet e mëdha që i ka ndaj kompanisë ODF. Llogaria e arkëtueshme e Agness në vlerë prej €4,700 konsiderohet si e pambledhshme.

Llogaria	Asetet		Detyrimet	Ekuiteti	
	Paraja	Asetet tjera		Kapitali i kontibuar	Fitimet e mbajtura
Shpenzimi i borxhit të keq					-144,000
Lejimet për borxhe të dyshimta		-144,000			
Lejimet për borxhe të dyshimta		4,700			
Llogari të arkëtueshme		-4,700			

3. Besa themeloi biznesin e saj me 1 jana 2010 duke investuar €15,000, me poshtë janë transaksionet që ndodhën gjatë muajit janar:

1. Bleu mallra për shitje me kredi (afat pagese) në vlerë prej 6,000
2. Shiti mallra në vlerë prej 5,500 me kredi, mallrat kishin kushtuar 4,000.
3. Pagoi qiranë për 1 vit në vlerë prej 2,400
4. Konsumatori që bleu mallrat në pikën 2, shfrytëzoi zbritjen prej 2% që i kishte ofruar Besa dhe pagoi gjithë borxhin e tij.
5. Besa tërheqi 500 për nevoja personale.
6. Shiti mallra në vlerë prej 3,000 me para të gatshme, mallrat kushtuan 2,000.
7. Pagoi mallrat e blera në pikën 1.
8. Pagoi pagat e muajit janar në vlerë prej 700

Kërkohet:

Përgatitni një pasqyrë të të ardhurave për muajin janar duke supozuar se sot është data 31 janar 2010.

*Shënim: mund të paraqitni transaksionet në formën në vijim. Gjithashtu mund të fitoni pikë shtesë nëse transaksionet e mësipërme i paraqitni në ditarin kryesor.*

Llogaria	Asetet		Detyrimet	Ekuiteti	
	Paraja	Asetet tjera		Kapitali i kontibuar	Fitimet e mbajtura
Paraja	15,000				
Kapitali				15,000	
Stoqet		6,000			
Llogaria e pagueshm			6,000		
Llogaria e arkëtueshme		5,500			
Të hyra nga shitja					5,500
KMSH					-4,000
Stoqet		-4,000			
Parapagimi i qirasë		2,400			
Paraja	-2,400				
Zbritjet nga shitja					-110
Paraja	5,390				
Llogaria e akrëtueshme	-5,500				
Kapitali				-500	
Paraja	-500				
Paraja	3,000				
Të hyrat nga shitja					3,000
Llogaria e pagueshme			-6,000		
KMSH					-2,000
Stoqet		-2000			
Paraja	-6,000				

Shpenzimet e pagave					-700
Paraja	-700				
Shpenzimi i qirasë					-200
Parapagimi		-200			

*Pasqyra e të ardhurave:*

Të hyrat nga shitja	8,500
Zbritjet nga shitja	<u>(110)</u>
Të hyrat neto	8,390
KMSH	<u>(6,000)</u>
<b>Fitimi bruto</b>	<b>2,390</b>
Shpenzimet	
Pagat	(700)
Qiraja	<u>(200)</u>
<b>Gjithsej shpenzime</b>	<b>(900)</b>
<b>Fitimi neto</b>	<b>1,490</b>